VENDIM
Nr. 62, datë 23.10.2025

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahimi	anëtar;
Marjana Semini	anëtare,

me sekretare Anjeza Puka, në datën 23.10.2025, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 5 (F) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Fatos Metushi, përfaqësuar nga avokati Ilir Oboni, me akt përfaqësimi.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme, përfaqësuar nga prokurori Hysen Keta, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 62-2019-5240 (1523), datë 21.10.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; nr. 669, datë 5.12.2019, të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2024-1085, datë 11.6.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 42, 43, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*;* nenet 27, 28 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", të ndryshuar *(ligji organik i Gjykatës)*.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuesit Fatos Metushi (*kërkuesi*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është akuzuar për kryerjen e veprës penale "Vrasja me paramendim", të parashikuar nga neni 78 i Kodit Penal *(KP)*, për të cilën, në përfundim të gjykimit të zhvilluar në mungesë të tij, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 63, datë 23.2.2000 *(vendimi nr. 63/2000)*, e ka dënuar me 25 vjet burg. Ky vendim ka marrë formë të prerë, pasi nuk është ankimuar nga palët dhe në datën 9.3.2000, organi i ndjekjes penale ka nxjerrë urdhrin për ekzekutimin e tij.

2. Kërkuesi është arrestuar në shtetin grek, bazuar në urdhërarrestin ndërkombëtar të lëshuar ndaj tij, dhe është ekstraduar për në Shqipëri në datën 2.8.2019, ndërsa në datën 3.8.2019, është vënë në dijeni nga autoritetet shqiptare për ekzekutimin e vendimit nr. 63/2000, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Bazuar në nenin 147 të Kodit të Procedurës Penale *(KPP)*, në datën 13.8.2019, ai i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me kërkesë për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit ndaj vendimit të fajësisë, duke pretenduar se procedimi penal dhe gjykimi i çështjes penale ishin bërë në kundërshtim me nenet 140, 141 e vijues të KPP-së, që përcaktojnë detyrimin për njoftimin e të pandehurit të lirë ose të paraburgosur, dhe vendimin unifikues nr. 1, datë 15.2.2001 *(vendimi unifikues nr. 1/2001)* të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

3. Me vendimin nr. 62-2019-5240 (1523), datë 21.10.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur mospranimin e kërkesës për rivendosje në afat, me argumentin se ajo nuk ishte shoqëruar me ankimin, çka sipas nenit 420/1 të KPP-së passillte mospranimin e saj. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka ushtruar ankim.

4. Me vendimin nr. 669, datë 5.12.2019, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit, duke e gjetur atë të drejtë dhe të bazuar në ligj. Sipas kësaj gjykate, neni 420/1 i KPP-së përcaktonte qartësisht detyrimin për shoqërimin e kërkesës për rivendosje në afat me ankimin ndaj vendimit që kundërshtohej, si dhe pasojën në rast të mospërmbushjes së këtij detyrimi, konkretisht mospranimin e kërkesës si rrjedhojë e pamundësisë së gjykatës për të vlerësuar në themel shkaqet e ngritura në të. Po sipas gjykatës së apelit, depozitimi i ankimit nga kërkuesi pas dhënies së vendimit nga gjykata e rrethit dhe tej afatit ligjor të parashikuar nuk e bënte të cenueshëm vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier për mospranimin e kërkesës. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka ushtruar rekurs dhe më pas ka paraqitur shtesë të tij.

5. Me vendimin nr. 00-2024-1085, datë 11.6.2024, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se vendimet e gjykatave më të ulëta ishin marrë në interpretim e në zbatim të drejtë të ligjit. Ndërsa për sa u përket pretendimeve të parashtruara nga kërkuesi në shtesën e rekursit për rrëzimin nga gjykatat të kërkesës së tij për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, Kolegji Penal ka vlerësuar se ato nuk mund të merreshin në shqyrtim, pasi i përkisnin një gjykimi tjetër.

6. Në datën 29.1.2025, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* me ankim kushtetues individual, i cili, pas plotësimit sipas parashikimeve të nenit 27 të ligjit organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 4.2.2025.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

7. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

Në procesin e rivendosjes në afat të së drejtës së ankimit

7.1 *Së drejtës së aksesit substancial*, si rrjedhojë e mospranimit nga gjykatat e zakonshme të kërkesës së tij për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit dhe mosmarrjes parasysh nga Gjykata e Lartë të pretendimeve të tij kushtetuese për cenimin nga gjykatat e faktit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, barazisë së armëve, prezumimit të pafajësisë dhe parimit *in dubio pro reo*.

7.2 *Së drejtës së ankimit*, pasi vendimi nr. 63/2000, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është marrë në kundërshtim me parashikimet ligjore të njoftimit të të pandehurit të lirë, të paraburgosur ose të deklaruar në mungesë dhe përcaktimet e vendimit unifikues nr. 1/2001, të

Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Në procesin e rivendosjes në afat, gjykatat duhej të kishin marrë parasysh të drejtën e tij të ankimit ndaj vendimit të fajësisë.

7.3 *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi vendimet gjyqësore janë të paarsyetuara. Edhe pse në rekurs ishin ngritur pretendime për mosrespektim nga gjykatat e faktit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, Gjykata e Lartë nuk i ka marrë ato në shqyrtim dhe nuk u ka dhënë përgjigje të arsyetuar, duke u mjaftuar me një arsyetim *de plano*, i cili edhe pse është konsideruar i mjaftueshëm nga kjo Gjykatë dhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(GJEDNJ)*, është pranuar vetëm për rastet kur procesi në gjykatat e zakonshme nuk ka shfaqur probleme. Në rastin e tij, Gjykata e Lartë duhej të ishte investuar në shqyrtimin e pretendimeve për shkelje procedurale të parashtruara në rekurs dhe të mbante qëndrim të shprehur për to.

Në procesin penal të themelit

7.4 *Së drejtës për t'u njoftuar për gjykimin, për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur*, pasi ndonëse për periudhën 11.5.1999–23.2.2000 gjykimi i çështjes penale në ngarkim të tij është zhvilluar në praninë e mbrojtësit të caktuar kryesisht, kërkuesi nuk është njoftuar për seancat e zhvilluara në datat 2.4.1999 e 23.4.1999, në shkelje të neneve 140 e 351 të KPP-së dhe vendimit unifikues nr. 354, datë 28.7.1999, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë për njoftimin e të pandehurit të deklaruar në mungesë.

7.5 *Prezumimit të pafajësisë*, pasi dënimi penal është bazuar vetëm në deklarimet e tij, si person ndaj të cilit zhvilloheshin hetime dhe nuk ka asnjë provë tjetër që provon akuzën. Nënshkrimi i deklarimeve mbi të cilat është bazuar dënimi nuk është bërë prej tij, çka provohet edhe nga aktekspertimi i datës 2.12.2019.

8. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme*,** ka prapësuar:

Për legjitimimin

8.1 Kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae*, pasi aktet e përfaqësimit të bashkëlidhura me kopjet e kërkesave të drejtuara Gjykatës përmbajnë mangësi procedurale që cenojnë legjitimitetin e tij. Akti i përfaqësimit të mbrojtëses, e cila ka nënshkruar kërkesën e parë drejtuar Gjykatës, nuk është hartuar në përputhje me kërkesat e nenit 109 të KPP-së, pasi i mungon nënshkrimi i drejtorit të Institutit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale *(IEVP)*, Peqin, ose vula e këtij institucioni. Pavarësisht se plotësimi i tij është nënshkruar nga kërkuesi dhe mbrojtësi i tij tjetër, Ilir Oboni, akti i përfaqësimit të këtij të fundit ka të njëjtat mangësi si ai i mëparshmi.

Për themelin

8.2 Pretendimet për cenimin e *së drejtës së aksesit substancial* janë të pabazuara, pasi gjykatat kanë arsyetuar qartë për mangësitë procedurale në paraqitjen e kërkesës për rivendosjen në afat dhe pasojat që rrjedhin nga kjo. Në ankim, rekurs ose ankimin kushtetues individual kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë argument për mangësitë procedurale të konstatuara nga gjykatat. E drejta për t'iu drejtuar një gjykate nuk është absolute dhe rivendosja në afat e së drejtës së ankimit, sipas nenit 420/1 të KPP-së, është e ndryshme nga e drejta për rivendosje në afat, sipas nenit 147 të këtij kodi. Në lidhje me të parën, në nenin 420/1 ligjvënësi ka parashikuar shprehimisht detyrimin për shoqërimin e saj me ankimin ndaj vendimit penal dhe përmbajtja e kësaj dispozite përmbush kriteret e qartësisë dhe të parashikueshmërisë.

8.3 Pretendimet për cenimin e *së drejtës së ankimit* janë të pabazuara, pasi ndaj kërkuesit ka qenë caktuar masa e sigurimit personal "Arresti në burg" dhe ai është larguar nga burgu gjatë trazirave të vitit 1997. Pretendimet për vendimin nr. 63/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier i takojnë ankimit ndaj këtij vendimi, çka përbën akt procedural më vete dhe duhej të ishte paraqitur së bashku me kërkesën për rivendosje në afat. Humbja e së drejtës së ankimit është pasojë e mosveprimeve të kërkuesit, i cili edhe pse kishte në dispozicion mjetin ligjor, nenin

420/1 të KPP-së, nuk ka respektuar kërkesat formale të kësaj dispozite, detyrimi për plotësimin e të cilave është pranuar edhe nga jurisprudenca kushtetuese. Ankimi ndaj vendimit është paraqitur tej afatit ligjor 10-ditor, çka përbën arsye për mospranimin e kërkesës.

8.4 Pretendimet për *cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* janë të pabazuara, pasi gjykatat kanë dhënë përgjigje të arsyetuar për vendimmarrjet e tyre, Arsyetimi *de plano* i Gjykatës së Lartë është pasojë e mungesës së argumenteve dhe arsyetimit ligjor të kërkesës.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

9. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a, të ligjit organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

10. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka pretenduar se kërkuesi nuk plotëson kriterin e legjitimimit *ratione personae*, pasi aktet e përfaqësimit bashkëlidhur kërkesës drejtuar Gjykatës dhe plotësimit të saj nuk janë hartuar në përputhje me kërkesat e nenit 109 të KPP-së, për shkak se u mungon nënshkrimi i drejtorit të IEVP-së, Peqin. Ndërsa, sipas kërkuesit, prapësimet e organit të ndjekjes penale janë të pabazuara, pasi, në kundërshtim nga sa ky organ pretendon, akti i përfaqësimit i datës 4.11.2024 është nënshkruar nga drejtori i IEVP-së, Peqin dhe përmban vulën e këtij institucioni.

11. Neni 27, pika 2, shkronja "ë", i ligjit organik të Gjykatës parashikon se ankimi kushtetues individual duhet të përmbajë nënshkrimin e kërkuesit ose të përfaqësuesit të tij, si dhe aktin e përfaqësimit të këtij të fundit, ku sipas nenit 109 të KPP-së, akti i përfaqësimit (prokura) jepet me akt noterial ose me shkresë private të vërtetuar nga organet kompetente. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se, sipas nenit 70 të Kodit Civil, prokura përbën një akt përmes të cilit, me vullnetin e tij të lirë, i përfaqësuari përcakton karakterin dhe vëllimin e tagrave që i jep përfaqësuesit dhe, sipas nenit 70, të ligjit nr. 110/2018, "Për noterinë", mund të hartohet nga noteri edhe në mjediset e IEVP-së, Peqin. Po kështu, neni 111 i KPP-së ka përcaktuar të drejtën e individit që i është kufizuar liria për të paraqitur kërkesa, ankesa dhe deklarata nëpërmjet drejtorit të institucionit. Në interpretim të këtyre dispozitave, Gjykata vë në dukje se në rastin e individit të izoluar, aktet e paraqitura prej tij duhet të vërtetohen me nënshkrimin e drejtorit të IEVP-së, Peqin.

12. Në këndvështrim të parashikimeve të mësipërme ligjore, në rastin konkret, Gjykata vë në dukje se ankimi kushtetues individual i datës 29.1.2025, është nënshkruar vetëm nga mbrojtësja e zgjedhur nga kërkuesi, Sonila Çekrezi, ndërsa akti i përfaqësimit nuk është hartuar sipas formës së kërkuar nga ligji. Për këtë shkak, në zbatim të parashikimeve të nenit 27, pika 2, shkronja "ë", të ligjit organik të Gjykatës, kërkuesi është njoftuar për nevojën e plotësimit të kërkesës me aktin e përfaqësimit ose, në mungesë të tij, nënshkrimin e vetë kërkuesit. Në zbatim të kërkesave të Gjykatës, në datën 4.2.2025 kërkuesi ka plotësuar të metat, duke paraqitur kopje të ankimit kushtetues individual të nënshkruar prej tij dhe mbrojtësit të zgjedhur

prej tij, Ilir Oboni. Kjo kërkesë është shoqëruar me aktin e IEVP-së, Peqin ("vërtetim") për akomodimin e kërkuesit në këtë institucion, të cilit i është bashkëlidhur edhe akti i përfaqësimit të kërkuesit nga ky avokat. Të dyja këto dokumente mbajnë vulën e IEVP-së, Peqin.

13. Për sa më sipër, në kushtet kur ankimi kushtetues individual është nënshkruar nga vetë kërkuesi, si dhe ai ka qenë palë në gjykimin për të cilin janë dhënë vendimet gjyqësore të kundërshtuara, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar, Gjykata vlerëson se, në kundërshtim nga sa subjekti i interesuar pretendon, kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae,* bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës.

14. Për sa i takon kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja "a", të ligjit organik, Gjykata vëren se pretendimet e parashtruara në ankimin kushtetues individual kërkuesi i ka ngritur më parë, në formë dhe substancë, në gjykatat e zakonshme, për rrjedhojë e përmbush edhe këtë kriter.

15. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit organik të Gjykatës parashikon afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në rastin konkret, Gjykata vëren se vendimi nr. 63/2000 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, që ka përmbyllur procesin gjyqësor për shqyrtimin e themelit të çështjes, është i datës 23.2.2000, ndërsa kërkuesi i është drejtuar Gjykatës në datën 4.2.2025, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1085, datë 11.6.2024, ka vendosur mospranimin e kërkesës për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit.

16. Gjykata thekson se paraqitja e një kërkese për rivendosje në afat, që nuk pranohet nga gjykatat e zakonshme, nuk prek zgjidhjen përfundimtare të procesit gjyqësor penal. Ndaj, në paraqitjen e ankimit kushtetues individual, me objekt kundërshtimin e procesit të rivendosjes në afat, individët nuk mund të ngrenë pretendime për procesin gjyqësor penal të themelit, duke përdorur afatin ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit organik të saj referuar procesit të zhvilluar lidhur me mjetin e jashtëzakonshëm të ankimit, të rrëzuar nga gjykata si të pabazuar në ligj. Në këtë kontekst, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t'u njoftuar për gjykimin, për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur dhe parimit të prezumimit të pafajësisë, të cilat parashtrohen ndaj procesit penal në ngarkim të tij, nuk mund të merren në shqyrtim, pasi janë paraqitur haptazi jashtë afatit ligjor 4-mujor. Ndërsa, për sa u përket pretendimeve për procesin gjyqësor lidhur me kërkesën për rivendosje në afat, sipas informacionit të marrë në rrugë elektronike nga Gjykata e Lartë rezulton se vendimi i kësaj gjykate që ka përmbyllur këtë proces është publikuar në faqen e saj zyrtare në datën 16.10.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 4.2.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor. Në këto kushte, Gjykata çmon se kërkuesi legjitimohet *ratione temporis* për procesin gjyqësor që ka rrëzuar kërkesën e tij për rivendosje në afat.

17. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar se vendimet gjyqësore objekt të ankimit kushtetues individual i kanë cenuar *të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës në drejtim të *së drejtës së aksesit substancial*, *së drejtës së ankimit* dhe të *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pretendime të cilat përfshihen në juridiksionin kushtetues. Duke pasur parasysh argumentet në themel të tyre, Gjykata çmon të analizojë çështjen në vijim në drejtim të *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit substancial* në procesin gjyqësor për shqyrtimin e kërkesës për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit substancial

18. Kërkuesi ka pretenduar se mospranimi nga gjykatat i kërkesës për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit ndaj vendimit nr. 63/2000, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, të dhënë në mungesë të tij, i ka cenuar të drejtën e aksesit substancial. Po sipas kërkuesit, vendimet gjyqësore janë të paarsyetuara dhe, edhe pse në rekurs ishin ngritur pretendime për mosrespektimin nga gjykatat e faktit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, Gjykata e Lartë nuk i ka marrë ato në shqyrtim e nuk u ka dhënë përgjigje të arsyetuar, duke u mjaftuar me një arsyetim *de plano*. Kjo gjykatë duhej të ishte investuar në shqyrtimin e pretendimeve për shkelje procedurale të parashtruara në rekurs dhe të mbante qëndrim të shprehur për to.

19. Prokuroria e Përgjithshme ka prapësuar se pretendimet e kërkuesit për shkeljen e së drejtës së aksesit substancial janë të pabazuara, pasi ai ka pasur dijeni për procesin penal, duke qenë se ndaj tij ishte caktuar masa e sigurimit "Arresti në burg", dhe është larguar nga burgu gjatë trazirave të vitit 1997. Humbja e së drejtës së ankimit ndaj vendimit penal të fajësisë është pasojë e mosveprimeve të kërkuesit, i cili, edhe pse kishte në dispozicion mjetin ligjor, nenin 420/1 të KPP-së, nuk ka respektuar kërkesat formale të kësaj dispozite. Ankimi ndaj vendimit penal është paraqitur tej afatit ligjor 10-ditor, edhe pse përmbajtja e nenit 420/1 të KPP-së plotëson kriteret e qartësisë dhe të parashikueshmërisë. Ndërsa pretendimet për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor janë të pabazuara, pasi gjykatat kanë dhënë përgjigje të arsyetuar për vendimmarrjet e tyre. Arsyetimi *de plano* i Gjykatës së Lartë është pasojë e mungesës së argumenteve dhe arsyetimit ligjor të kërkesës.

20. Në nenin 42, pika 2, të Kushtetutës parashikohet se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e gjykimit të drejtë dhe publik brenda afatit të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, përfshirë të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik *(shih vendimet nr. 12, datë 28.2.2024; nr. 32, datë 3.11.2022; nr. 10, datë 12.4.2022, të Gjykatës Kushtetuese)*. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal *(shih vendimet nr. 30, datë 29.5.2023; nr. 6, datë 22.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese)*.

21. Gjykata ka pranuar, gjithashtu, se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë *(shih vendimet nr. 12, datë 28.2.2024; nr. 30, datë 29.5.2023; nr. 67, datë 10.11.2017, të Gjykatës Kushtetuese)*. Po sipas Gjykatës, është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e kësaj Gjykate është të shqyrtojë dhe të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës *(shih vendimet nr. 26, datë 29.4.2025; nr. 30, datë 29.5.2023, të Gjykatës Kushtetuese)*.

22. Në lidhje me rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit, në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se neni 420/1 i KPP-së synon mbrojtjen dhe administrimin e mirë të drejtësisë, përmes plotësimit të kushteve formale të kërkesës për rivendosje në afat. Sipas Gjykatës, norma

ligjore, në mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit nga gjykatat, plotëson kriterin e qartësisë dhe të parashikueshmërisë, ndaj dhe një kërkues, përmes përfaqësuesit ligjor, është i qartë paraprakisht për plotësimin e kushteve dhe konkretisht të detyrimit për t'i bashkëlidhur kërkesës aktin e kërkuar nga ligji, sipas formës dhe mënyrës së kërkuar *(shih vendimin nr. 30, datë 29.5.2023, të Gjykatës Kushtetuese)*.

23. Në vështrim të jurisprudencës së mësipërme kushtetuese, Gjykata vlerëson të analizojë në vijim nëse vendimmarrja e gjykatave të zakonshme i ka cenuar kërkuesit të drejtën e aksesit substancial, si dhe nëse interpretimi prej tyre i nenit 420/1 të KPP-së ka qenë ose jo arbitrar në këndvështrimin kushtetues, në kuptimin që bie ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë.

24. Duke iu referuar përmbajtjes së nenit 420/1, pika 1, të KPP-së, Gjykata vëren se palët rivendosen në afatin e ankimit kur provojnë se nuk kanë pasur mundësi ta respektojnë afatin për shkak të rastit fator ose të forcës madhore. Po sipas kësaj dispozite, kërkesa për rivendosje në afat shoqërohet së bashku me ankimin dhe pasoja që parashikohet kur nuk shoqërohet me ankim është mospranimi i kërkesës për rivendosje në afat. Ndërsa sipas pikës 2, kur gjykimi është zhvilluar sipas parashikimeve të nenit 351 të këtij kodi, i pandehuri mund të kërkojë rivendosjen në afat për të bërë ankim kur provon se nuk ka marrë dijeni për vendimin.

25. Në rastin konkret, nga materialet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të gjykimit kushtetues, Gjykata konstaton se kërkuesi është akuzuar për kryerjen e veprës penale "Vrasja me paramendim", shkak për të cilin është arrestuar, duke u caktuar ndaj tij masa e sigurimit "Arresti në burg" nën të cilën ka qëndruar nga data 19.2.1997 deri në datën 13.3.1997, të hapjes së IEVP-ve për shkak të trazirave, kur dhe është larguar jashtë vendit *(shih faqet 141–142 të dosjes gjyqësore nr. 63/2000, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier)*. Në këtë situatë, procesi gjyqësor penal është zhvilluar në mungesë të tij e në prani të mbrojtësit të caktuar kryesisht dhe në përfundim të gjykimit kërkuesi është dënuar me 25 vjet burgim me vendimin nr. 63/2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, që ka marrë formë të prerë për shkak se nuk është ankimuar. Ai është arrestuar në shtetin grek nga ku është ekstraduar për në Shqipëri në datën 2.8.2019 dhe në vijim ka paraqitur kërkesë për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit ndaj vendimit penal të dënimit, duke pretenduar se gjykimi ishte bërë në mungesë e pa dijeninë e tij, në kundërshtim me parashikimet e neneve 140 e 141 të KPP-së dhe vendimin unifikues nr. 1/2001 të Gjykatës së Lartë.

26. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur mospranimin e kërkesës, me argumentin se ajo nuk ishte shoqëruar me ankimin ndaj vendimit penal nr. 63/2000 të saj, për të cilin kërkohej rivendosja në afat, kusht ky i domosdoshëm, sipas parashikimeve të nenit 420/1, pika 1, të KPP-së. Vendimi i gjykatës së rrethit është vlerësuar i drejtë në thelb nga gjykata e apelit, e cila ka vënë në dukje se ankimi ndaj vendimit nr. 63/2000 ishte depozituar në sekretarinë gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier në datën 29.10.2019, pra 8 ditë pas datës 21.10.2019, të dhënies së vendimit objekt ankimi dhe tej afatit të parashikuar nga neni 420/1 i KPP-së. Po sipas gjykatës së apelit, mosshoqërimi i kërkesës me ankimin dhe pretendimet ndaj vendimit të çështjes penale të themelit bënte që gjykata të ishte në pamundësi të vlerësonte në themel shkaqet e ngritura për atë vendim dhe paraqitja e ankimit pas dhënies nga gjykata e rrethit të vendimit për kërkesën për rivendosje në afat, nuk e bënte të cenueshëm vendimin e kësaj të fundit. Në vijim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit kanë zbatuar dhe interpretuar drejt ligjin procedural.

27. Në analizë të vendimmarrjeve gjyqësore përkundrejt parashikimeve ligjore të nenit 420/1 të KPP-së, Gjykata vëren se mospranimi nga gjykatat e zakonshme të kërkesës për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit është rrjedhojë e mosveprimeve në përputhje me përcaktimet ligjore nga ana e kërkuesit. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se aktet

normative marrin fuqi juridike pasi botohen në Fletoren Zyrtare dhe prezumimi *"nemo censetur ignorare legem"* (askush nuk mund të quhet se nuk e njeh ligjin) gjen zbatim që në momentin e botimit të ligjit në këtë fletore e kalimit të afatit të caktuar pas botimit, si kusht i domosdoshëm për hyrjen e tij në fuqi *(shih vendimet nr. 47, datë 7.7.1999; nr. 3, datë 23.2.1995, të Gjykatës Kushtetuese)*. Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, në rastin konkret Gjykata vlerëson se kërkuesi kishte mundësi, qoftë edhe përmes ndihmës së mbrojtësit, të parashikonte pasojën e mospranimit të kërkesës për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit, në zbatim të dispozitave të lartpërmendura të KPP-së, si rrjedhojë e mosshoqërimit të saj me ankimin ndaj vendimit gjyqësor të themelit.

28. Për sa më lart, duke vlerësuar rëndësinë e administrimit të mirë të drejtësisë që neni 420/1 i KPP-së synon, e balancuar kjo me interesat e kërkuesit, i cili me nismën e tij vë në lëvizje gjykatën, Gjykata çmon se interpretimi që gjykatat e zakonshme i kanë bërë nenit 420/1 të KPP-së nuk është arbitrar në këndvështrimin kushtetues. Po kështu, në kundërshtim nga sa kërkuesi pretendon, këto gjykata kanë arsyetuar vendimmarrjet e tyre, duke dhënë përgjigje të arsyetuara për shkakun ligjor të mospranimit të kërkesës për rivendosje në afat, konkretisht mosshoqërimin e saj me ankimin ndaj vendimit penal, si kusht i domosdoshëm për të vijuar me shqyrtimin e themelit të pretendimeve. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor janë të pabazuara.

29. Në përfundim, Gjykata vlerëson se kërkesa është e pabazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, për rrjedhojë rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 23.10.2025.

Shpallur më 4.12.2025.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini, Sandër Beci

Anëtarë pjesërisht kundër: Genti Ibrahimi, Ilir Toska, Sonila Bejtja

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen nr. 5 (F) 2025 të Regjistrit Themeltar, me kërkues Fatos Metushin, në ndryshim nga shumica, vlerësojmë se pretendimet e kërkuesit për vendimmarrjen e gjykatës që ka shqyrtuar kërkesën e tij për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit, janë të bazuara, për rrjedhojë duhej të ishte vendosur pranimi pjesërisht i kërkesës dhe shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-1085, datë 11.6.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe dërgimi i çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë.

2. Kërkuesi, edhe pse në objekt të kërkesës ka kundërshtuar formalisht vetëm vendimet gjyqësore të dhëna në lidhje me kërkesën e tij për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit,

pretendimet e tij i ka shtrirë edhe për procesin gjyqësor të themelit të çështjes penale, në të cilin, me vendimin nr. 63, datë 23.2.2000 *(vendimi nr. 63/2000)* të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ai është dënuar me 25 vjet burgim. Ky proces gjyqësor është zhvilluar në mungesë të kërkuesit dhe në prani të një avokati të caktuar kryesisht nga gjykata. Pas kalimit të afatit të ankimit, ai vendim ka marrë formë të prerë në datën 9.3.2000 dhe organi i prokurorisë ka nxjerrë urdhrin për ekzekutimin e tij. Kërkuesi në vijim është arrestuar në shtetin grek, bazuar në urdhrin e arrestit ndërkombëtar të lëshuar ndaj tij, dhe është ekstraduar në Shqipëri në datën 2.8.2019, ndërsa në datën 3.8.2019, ai është vënë në dijeni nga autoritetet shqiptare për ekzekutimin e dënimit me burgim të caktuar me vendimin nr. 63/2000, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

3. Në datën 13.8.2019, kërkuesi, bazuar në nenin 147 të KPP-së, ka paraqitur në gjykatë një kërkesë për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit ndaj vendimit penal të dënimit të tij. Në përfundim të shqyrtimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 62-2019-5240 (1523), datë 21.10.2019, ka vendosur mospranimin e kësaj kërkese, me arsyetimin se ajo nuk është shoqëruar me aktin e ankimit kundër vendimit për të cilin kërkohej rivendosja në afat e së drejtës së ankimit, çka sipas nenit 420/1 të KPP-së passillte mospranimin e kërkesës. Megjithëse kërkuesi ka paraqitur ankim, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 669, datë 5.12.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke pranuar si të drejtë përfundimin e asaj gjykate për interpretimin dhe zbatimin e pikës 1 të nenit 420/1 të KPP-së. Ajo gjykatë, po ashtu, ka arsyetuar se depozitimi i ankimit nga kërkuesi pas dhënies së vendimit nga gjykata e shkallës së parë dhe tej afatit ligjor të parashikuar nuk e bënte të cenueshëm vendimin e kësaj të fundit për mospranimin e kërkesës për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit. Kurse për rekursin e kërkuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-1085, datë 11.6.2024, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se nuk përmbante asnjë nga shkaqet që parashikohen në nenin 432 të KPP-së dhe se vendimet e gjykatave më të ulëta ishin marrë në interpretim e në zbatim të drejtë të ligjit.

4. Në datën 29.1.2025 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve të dhëna në procesin gjyqësor për kërkesën e tij për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit, ankim, i cili, pas plotësimit sipas parashikimeve të nenit 27 të ligjit organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 4.2.2025.

5. Në këtë ankim kushtetues individual kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së njoftimit të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, parimit të barazisë së armëve dhe atij të prezumimit të pafajësisë, pretendime këto që i adresohen procesit gjyqësor për themelin e çështjes penale, i cili nuk është objekt i ankimit kushtetues individual. Pavarësisht kësaj, duke pasur parasysh natyrën e këtyre pretendimeve, Gjykata do të duhej t'i mbante në vëmendje në funksion të procesit tjetër gjyqësor objekt i këtij gjykimi, që ka vendosur për kërkesën për rivendosjen në afat, konkretisht në këndvështrim të pretendimit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit substancial.

6. Shumica ka arritur në përfundimin se pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit substancial, është i pabazuar, me arsyetimin se duke vlerësuar rëndësinë e administrimit të mirë të drejtësisë që neni 420/1 i KPP-së synon, e balancuar kjo me interesat e kërkuesit, i cili me nismën e tij vë në lëvizje gjykatën, interpretimi që gjykatat e zakonshme i kanë bërë kësaj dispozite ligjore nuk është arbitrar në këndvështrimin kushtetues dhe se në kundërshtim nga sa kërkuesi pretendon, këto gjykata kanë arsyetuar vendimmarrjet e tyre, duke dhënë përgjigje të arsyetuara për shkakun ligjor të mospranimit të kërkesës për rivendosjen në afat, konkretisht mosshoqërimin e saj me

ankimin ndaj vendimit penal, si kusht i domosdoshëm për të vijuar me shqyrtimin e themelit të pretendimeve (*shih paragrafin 28 të vendimit*). Mbi këtë bazë shumica ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuesit.

7. Për përfundimin si më lart dhe zgjidhjen e kësaj çështjeje, ne, si gjyqtarë në pakicë, ndajmë qëndrim të ndryshëm, duke vlerësuar se ky pretendim i kërkuesit është i bazuar dhe, për pasojë, kërkesa e tij, për sa i përket shfuqizimit të vendimit nr. 00-2024-1085, datë 11.6.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, duhej të pranohej.

8. Në rastin konkret, vlerësojmë se është i zbatueshëm vetëm neni 420/1 i KPP-së, i shtuar me ligjin nr. 35/2017, sipas të cilit: "*1. Palët rivendosen në afatin e ankimit kur provojnë se nuk kanë pasur mundësi ta respektojnë afatin për shkak të rastit fator ose të forcës madhore. Kërkesa shoqërohet së bashku me ankimin, me pasojë mospranimi. 2. Kur gjykimi është zhvilluar sipas parashikimeve të nenit 351, të këtij Kodi, i pandehuri mund të kërkojë rivendosjen në afat për të bërë ankim kur provon se nuk ka marrë dijeni për vendimin. 3. Kërkesa për rivendosjen në afat paraqitet brenda dhjetë ditëve nga zhdukja e faktit që përbënte rast ose forcë madhore, kurse në rastet e parashikuara në paragrafin 2 të këtij neni, nga dita kur i pandehuri ka marrë dijeni efektivisht për vendimin. Rivendosja në afat nuk lejohet më shumë se një herë për secilën palë dhe për çdo shkallë të procedimit ...*".

9. Kjo dispozitë ka përcaktuar kushtet e pranueshmërisë për shqyrtim të kërkesës, konkretisht formën, subjektin dhe afatin. Nga ana tjetër, ajo ka parashikuar qartësisht edhe pasojën në rastin kur nuk plotësohen këto kërkesa ligjore. Dispozita kërkon paraqitjen e një kërkese formale për rivendosjen në afat të ankimit, të shoqëruar me ankimin, i cili sigurisht duhet të plotësojë kriterin formal, sikurse kërkon edhe neni 412 i KPP-së. Megjithatë, kjo dispozitë, ndryshe nga sa kanë vepruar gjykatat e zakonshme, nuk mund të interpretohet se përjashton mundësinë e përfshirjes së ankimit (elementeve formale të tij) brenda kërkesës për rivendosjen në afat, situatë e cila do të kënaqte atë kërkesë të ligjit për formalizimin e ankimit në funksion të miradministrimit të drejtësisë.

10. Duke iu referuar akteve bashkëlidhur kërkesës në shqyrtim, rezulton se kërkuesi ka paraqitur kërkesë formale për rivendosjen në afat, por pa e shoqëruar atë me një akt tjetër formal të ankimit kundër vendimit të njohjes të vendimit penal të huaj. Megjithatë, referuar përmbajtjes së kërkesës, krahas pretendimeve për rivendosjen në afat të ankimit, rezulton që kërkuesi të ketë parashtruar edhe pretendime për vendimin penal të dënimit të tij me burgim, për të cilin kërkonte të rivendosej në afat, konkretisht mohimin atij të së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur për shkak të mosrespektimit të dispozitave procedurale penale në lidhje me njoftimin e të pandehurit dhe zhvillimin e gjykimit në mungesë të tij, pa pasur ai dijeni, në shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së. Po kështu, edhe në parashtrimet me shkrim gjatë shqyrtimit të kërkesës për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit, në funksion të pretendimit si më lart, kërkuesi ka evidentuar dhe analizuar njoftimet e bëra për të, sikundër edhe kuadrin ligjor përkatës dhe jurisprudencën unifikuese, duke konsideruar se nuk i është garantuar e drejta për proces të rregullt ligjor sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ-së. Në këtë rast, ai ka shtuar edhe një pretendim tjetër, për sa i përket marrjes së provave në kundërshtim me ligjin dhe mungesën e provave për fajësinë e tij.

11. Të njëjtat pretendime si më lart kërkuesi i ka parashtruar edhe në apelin e tij kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë për mospranimin e kërkesës për rivendosjen në afat të ankimit. Përpos kësaj, pretendimet për vendimin penal të dënimit të tij me burgim, për të cilin kërkonte të rivendosej në afat, kërkuesi i ka parashtruar edhe në një akt të veçantë, të cilin e ka paraqitur në vijim të ankimit kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë për mospranimin e kërkesës për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit.

12. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe i rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes të të drejtave kushtetuese të individit dhe problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimin nr. 6, datë 16.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, Gjykata ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes (*shih vendimet nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 7, datë 7.2.2017; nr. 6, datë 16.2.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në këtë kuptim, shumica duhej të ndalej në mënyrën sesi është interpretuar dhe zbatuar neni 420/1 i KPP-së nga gjykatat e zakonshme që kanë shqyrtuar kërkesën për rivendosjen në afat të ankimit dhe nëse kjo mënyrë ka cenuar të drejtat kushtetuese të kërkuesit. Kjo çështje merr veçanërisht rëndësi, duke pasur parasysh dy fakte me natyrë kushtetuese: i. procesi gjyqësor i dënimit penal të kërkuesit është bërë në mungesë dhe ai nuk ka pasur mundësi të ushtrojë të drejtat e tij kushtetuese; ii. pretendimet, në thelb, kanë të bëjnë me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, përveç edhe me parimin e prezumimit të pafajësisë dhe atij për të mos u deklaruar fajtor mbi prova të mbledhura në mënyrë të paligjshme.

14. Për nga natyra e pretendimeve dhe natyra e procesit gjyqësor në tërësinë e tij, gjykatat e zakonshme nuk duhej të mbanin një qasje të tillë formaliste, por duhej të ushtronin funksionin e tyre kushtetues dhe ligjor, duke synuar të drejtën. Gjykatat e zakonshme kanë detyrimin që interpretimi që u bëjnë dispozitave ligjore gjatë zbatimit të tyre të shkojë drejt mbrojtjes të të drejtave të individit, veçanërisht atij që është dënuar e gjykuar në mungesë dhe nuk ka pasur asnjë mundësi të mbrohet ose të parashtrojë qëndrimin e tij. Të tilla qëndrime të gjykatave të zakonshme (duke pasur parasysh, ritheksojmë, se në kërkesën për rivendosjen në afat të ankimit kërkuesi ka parashtruar edhe elementet formale të ankimit kundër vendimit penal të dënimit me burgim të tij) kthehen në kufizuese të të drejtave të individit dhe vënë në dyshim të drejtën për proces të rregullt ligjor.

15. Edhe GJEDNJ-ja në jurisprudencën e saj është shprehur se fakti që aplikanti ishte në gjendje të paraqiste çështjen e tij përpara një gjykate, nuk përmbush domosdoshmërish në vetvete kërkesat e nenit 6/1 të KEDNJ-së. Rregullat që disiplinojnë hapat formalë që duhen ndërmarrë për paraqitjen e një ankimi synojnë të sigurojnë miradministrimin e drejtësisë *(shih Société Anonyme Sotiris dhe Nikos Koutras Attee kundër Greqisë, datë 16.11.2001; Brualla Gómez de la Torre kundër Spanjës, datë 19.12.1997; Saez Maeso kundër Spanjës, datë 9.11.2004).* Gjykatat kanë detyrimin që të sillen në atë mënyrë që të tilla kërkesa të mos e humbasin qëllimin e tyre dhe individit të mos i cenohet në thelb edhe e drejta për një mjet juridik efektiv. Në këtë kuptim, qasja e gjykatave në rastin konkret, duke verifikuar formalisht paraqitjen e kërkesës, pa u ndalur në leximin e saj tërësor, ka cenuar në thelb të drejtën e aksesit substancial të kërkuesit në gjykatë, për më tepër në kushtet kur ai nuk ka në dispozicion asnjë mjet tjetër juridik për të kërkuar rivendosjen e të drejtave të cenuara.

16. Duke pasur parasysh qëndrimin e gjykatave të zakonshme, në kuptim të pozicionit e funksionit të saj sipas nenit 141 të Kushtetutës, i takonte Gjykatës së Lartë që t'i jepte një interpretim të drejtë normës ligjore në kuptim të zbatimit të saj, në rastin konkret në zbatim të parimit të subsidiaritetit, pasi, siç është pohuar në jurisprudencën kushtetuese, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese është, në radhë të parë, funksion i gjykatave të

zakonshme (*shih vendimet nr. 38, datë 2.12.2021; nr. 13, datë 9.3.2021; nr. 11, datë 16.4.2018, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjykata e Lartë, në arsyetimin e saj, ka vlerësuar se vendimmarrja e gjykatës së apelit është marrë në zbatim të drejtë të ligjit procedural penal, në një kohë kur kjo e fundit, nga njëra anë, ka parashtruar si argument për mospranimin e kërkesës për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit, pikërisht mosparaqitjen nga kërkuesi të aktit formal të ankimit, ndërkohë që, nga ana tjetër, në arsyetimin e vendimit të saj, ka evidentuar edhe pretendimet e kërkuesit ndaj vendimit penal të dënimit të tij me burgim, sikurse ato ishin pasqyruar në ankimin e tij formal kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë, por edhe në kërkesën për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit.

18. Nga ana tjetër, edhe shumica duhej të kishte evidentuar në rastin konkret problematikat që shoqërojnë këtë çështje, që në nivel kushtetues kanë sjellë mohimin e të drejtave të kërkuesit për t'u mbrojtur në procesin penal të dënimit të tij me burgim. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar gjerësisht se i gjykuari në mungesë duhet të ketë të gjitha mundësitë që të kundërshtojë procesin penal ndaj tij, duke iu garantuar çdo e drejtë që buron nga dispozitat kushtetuese. Megjithatë, shumica nuk arriti të shkojë përtej vlerësimit formal të kritereve ligjore që kanë bërë edhe gjykata e zakonshme. Në vlerësimin tonë, të tilla çështje janë të rëndësishme jo vetëm për sa u përket të drejtave që kërkohen të mbrohen dhe që vihen në diskutim, por ato i japin mundësinë kësaj Gjykate të zgjerojë këndvështrimin dhe mbrojtjen kushtetuese të individit, veçanërisht kur bëhet fjalë për kufizimin e lirisë personale.

19. Në përfundim, ndryshe nga shumica, vlerësojmë se interpretimi që gjykatat e zakonshme i kanë bërë nenit 420/1 të KPP-së duket i paarsyeshëm, duke i cenuar kërkuesit të drejtën për akses substancial. Për pasojë, pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit substancial është i bazuar, ndaj Gjykata duhej të vendoste pranimin pjesërisht të kërkesës dhe, për rrjedhojë, shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-1085, datë 11.6.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe dërgimin e kësaj çështjeje për rishqyrtim po në atë gjykatë.

Anëtarë: Genti Ibrahimi, Ilir Toska, Sonila Bejtja